



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 052/p1-913 dt. 08/01/ 2026

RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025

JANAR-DHJETOR, 2025

Hyrje:

Kuvendi i Komunës funksionon në bazë të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), dhe Rregullores së punës të Kuvendit dhe akteve tjera në fuqi.

- Kuvendi i Komunës së Drenasit gjatë periudhës **Janar-Dhjetor 2025**, ka organizuar dhe mbajtur mbledhjet për Komitetin për Politikë e Financa dhe mbledhjet e Kuvendit Komunal.

Gjatë periudhës **Janar-Dhjetor 2025**, Kuvendi Komunal ka mbajtur **gjithsej 23 mbledhje**: Prej tyre **9 mbledhje** të rregullta të Kuvendit Komunal, **8 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa**, **mbledhje Solemne 3**, **mbledhje Urgjente 0** dhe **mbledhje të jashtëzakonshme 2 dhe një (1) mbledhje inauguruese**.

Nga incizimet e seancave të Kuvendit janë **bërë gjithsej njëzet e një (21) procesverbale**, prej tyre **9 (nëntë) procesverbale të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit**, **tetë (8) të mbledhjeve të KPF-së** dy të mbledhjeve të jashtëzakonshme, **një të mbledhjes inauguruese dhe një të degjimeve buxhetore**.

- Gjatë periudhës Janar - Dhjetor janë miratuar nga Kuvendi Komunal Drenas, gjithsej: **43 vendime** prej tyre **4 nuk janë në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** tri (3) janë shfuqizuar ndërsa një është rishqyrtuar, ndërsa në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi mbeten **39 vendime**.

Të gjitha aktet komunale janë të përkthyer në gjuhën serbe dhe të bashkangjitura në dosje fizike dhe në intranet si dhe janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të Komunës.

- Sa rregullore ka miratuar kuvendi i komunës për periudhën Janar – Dhjetor 2025 (Te bashkëngjitet lista me emrat e rregulloreve) ?

Gjatë periudhës raportuese nuk ka pas rregullore vetëm plotësim rregullore.

Në vitin 2023 Kuvendi i Komunës së Drenasit ka themeluar tri komitete konsultative:

- Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.
- Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
- Komitetit Konsultativ për Përshtetësi me Aftësi të Kufizuara.

Këto komitete nuk po mbajnë takime, arsyet e mospageses.

Kërkesa drejtuar **Komisionit për Emërim të Rrugëve** të pranuar në zyrën e Kuvendit, për emërim të ri të emrave të rrugëve dhe ndryshim të emrave të cilat janë emëruar më herët janë: gjashtëdhjetetë (68), të vitit 2017, njëzetënjë (21), të vitit 2018, nëntëdhjetë e dy (92), të vitit 2019, dhe 4, janë pa vit të shënuara, shtatëdhjetë e katër (74) janë të Vitit 2020, dyzetetë 48 të vitit 2021, (22) njëzetë dy të vitit 2022, dhe 87 kërkesa të vitit 2023, ndërsa për vitin 2024 janë gjithsej 64 kërkesa dhe për vitin 2025 gjithsej 46 kërkesa.

Në sistem të intranetit janë miratuar shumica e lendeve me përjashtim atyre që e presim afatin ligjor.

Zyra e Kuvendit ka raportuar me raporte MAPL-së, tremujore gjashtëmujore, vjetor.

Paraqitja e detajuar e shqyrtimit të pikave të rendit të ditës në mbledhjet e mbajtura të Komitetit për Politik dhe Financa dhe mbledhjet e Kuvendit si dhe miratimi i Raporteve dhe Vendimeve të Kuvendit Komunal të miratuara gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2025.

- Më poshtë janë të cekura mbledhjet dhe rendi i ditës të shqyrtuara nga Kuvendi Komunal për periudhën Janar-Dhjetor 2025.

Janar, 2025

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 22.01.2025 , janë shqyrtuar (7) shtatë pika të rendit të ditës.

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 19.12.2024.
2. Raporti i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2024.
3. Propozim vendim për plotësim/ndryshimin e vendimit nr.02-400/01-57008, dt 29.11.2024 për miratimin e Raportit të Komisioneve Komunale përfundimtare për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.
4. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me aftësi të kufizuara.
5. Propozim vendim për ndryshim-plotësimin e rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.
6. Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2024
7. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 31.01.2025, ku janë shqyrtuar (7) shtatë pika të rendit të ditës, janë miratuar 2 vendime.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i dt. 30.12.2024
2. Propozim vendim për ndryshim-plotësimin e rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.
3. Propozim vendim për plotësim/ndryshimin e vendimit nr.02-400/01-57008, dt 29.11.2024 për miratimin e Raportit të Komisioneve Komunale përfundimtare për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.
4. Raporti i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2024.
5. Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2024

6. Raporti vjetor i Komitetit Konsultativ për Persona me aftësi të kufizuara.
7. Të ndryshme.

Shkurt, 2025

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 19.02.2025, janë shqyrtuar 4 katër pika të rendit të ditës.

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 22.01.2025.
2. Raporti i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Komunën e Drenasit për vitin 2024.
3. Propozim vendim për plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
4. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më 28.02.2025, ku janë shqyrtuar 4 (katër) pika të rendit të ditës, është miratuar 1 vendim.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i dt. 31.01.2025.
2. Raporti i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Komunën e Drenasit për vitin 2024.
3. Propozim vendim për plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
4. Të ndryshme.

Mbledhja Solemne e Kuvendit Komunal për nderë të Ditës së Pavarësisë së Kosovës , është mbajtur më: 14.02.2025, me këtë rend dite:

11:00 - Hapja e mbledhjes Solemne të Kuvendit të Komunës nga kryesuesi z.Bekim Lestrani.

2. 11:15 Fjalimi i Kryetarit të Komunës së Drenasit z.Ramiz Lladrovci

3. 11:30 - Mbyllja e mbledhjes Solemne të Kuvendit të Komunës

Mars, 2025

Mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunës Drenas, kushtuar "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Rënies Heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë të rënëve për liri"

05.03.2025.

1. Hapja e mbledhjes Solemne të Kuvendit të Komunës Drenasit nga Kryesuesi z. Bekim Lestrani;
2. Fjalimi i Kryetarit të Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci;
3. Fjalë përshëndetëse nga grupet parlamentare ;
4. Mbyllja e mbledhjes solemne të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 19.03.2025, janë shqyrtuar shtatë (7) pika ne rend dite.

1. Procesverbalin e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më datën 19.02.2025;
2. Raport për implementimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit me temë: Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2023;
3. Raporti vjetor i KRM “ Pastrimi “, për vitin 2024;
4. Raporti vjetor i NPL “Stacioni i Autobusëve-Drenas”;
5. Plani lokal i veprimtimit zbutës për mbrojtje nga dhuna në familje dhe nga dhuna ndaj grave dhe vajzave Drenas 2025-2028;
6. Draft-propozim për ndryshim-plotësim të rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa, dhe gjoba 02 nr.400/03-62198 datës 28.12.2023;
7. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 28.03.2025, ku janë shqyrtuar (10) dhjetë pika të rendit të ditës dhe janë miratuar tre (4) vendime.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal i dt. 28.02.2025.
2. Draft-propozim për ndryshim-plotësim të rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa, dhe gjoba 02 nr.400/03-62198 datës 28.12.2023.
3. Propozim-Vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negociimit të ofertës për pronën komunale: P-70315035-00848-0, në Krajkovë, me sipërfaqe 130000 m².
4. Propozim-Vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negociimit të ofertës për pronën komunale: P-70310053-00539-0, në Negroc, me sipërfaqe 109084 m².
5. Propozim-Vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite, pronën e paluajtshme të komunës, me procedurë të negociimit të ofertës për pronën komunale: P-70315035-00913-0, në Krajkovë me sipërfaqe 92000 m².
6. Raport për implementimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit me temë: Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2023;
7. Raporti vjetor i KRM “ Pastrimi “ për vitin 2024.
8. Raporti vjetor i NPL “Stacioni i Autobusëve-Drenas”
9. **Propozim vendim Për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Komunale për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Organizatave të Bizneseve në Komunën e Drenasit.**
10. Të ndryshme.

Gjatë mbledhjes së mbajtur më: 28.03.2025 të Kuvendit Komunal, nga 11 pika që ishin në rendin e ditës u shqyrtuan vetëm 8 prej tyre, dhe u miratuan katër pika të rendit të ditës me shumicë votash, katër pika të tjera ishin raporte dhe vetëm u diskutuan. Ndërsa për shkak të mungesës së kuorumit mbledhja u ndërpre rreth orës 12:40 min, ku e njëjta vazhdoi në ora 14:50 në mungesë kuorumi mbledhja përfundoi, dy pikat e mbetura nuk u votuan dhe u barten për mbledhjen e rregullt të radhës.

Si rrjedhojë, për procedurë ligjshmërie do të përcillen vetëm katër pika të miratuara në mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal.

Prill, 2025

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 18.04.2025, janë shqyrtuar nëntë (9), pika të rendit të ditës.

1. Procesverbalin e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më datën 19.03.2025;
2. Propozim-vendim për plotësim- ndryshimin e Rregullores, Komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të bizneseve në Komunën e Drenasit;
3. Plani lokal i veprimit zbutës për mbrojtje nga dhuna në familje dhe nga dhuna ndaj grave dhe vajzave Drenas 2025-2028;
4. Propozim-vendim për Kuvendin Komunal të Drenasit për ndarjen e mjeteve nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport nga kategoria e subvencioneve për vitin 2025;
5. Propozim-vendim për shpalljen e Lordit George Robertson, “Qytetar Nderi”, i Komunës së Drenasit;
6. Propozim-vendim për shpalljen e z. Javier Solana, “Qytetar Nderi”, i Komunës së Drenasit;
7. Propozim-vendim për shpalljen e znj. Madeline Albright, “Qytetar Nderi”, “Post mortum”, e Komunës së Drenasit;
8. Raporti financiar janar- mars 2025;
9. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 29.04.2025, ku janë shqyrtuar (17) shtatëmbëdhjetë pika të rendit të ditës dhe janë miratuar trembëdhjetë (13) vendime.

1. Procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit Komunal i mbajtur më datën 28.03.2025;
2. Propozim-vendim për shpalljen e Lordit George Robertson, “Qytetar Nderi”, i Komunës së Drenasit;
3. Propozim-vendim për shpalljen e z. Javier Solana, “Qytetar Nderi”, i Komunës së Drenasit;
4. Propozim-vendim për shpalljen e znj. Madeline Albright, “Qytetar Nderi”, “Post mortum”, e Komunës së Drenasit;
5. Propozim-vendim për plotësim- ndryshimin e Rregullores, Komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të bizneseve në Komunën e Drenasit;
6. Propozim-vendim për financimin e projektit “Kv Feronikeli femrat”
7. Propozim-vendim për financimin e projektit “Kv Feronikeli meshkujt”
8. Propozim-vendim për financimin e projektit “Fc Feronikeli 74”
9. Propozim-vendim për financimin e projektit “Kh Drenica”
10. Propozim-vendim për financimin e projektit “Kff Feronikeli femrat”
11. Propozim-vendim për financimin e projektit “Klubi Futsalit Drenasi”
12. Propozim-vendim për financimin e projektit “Fc Liqeni”
13. Propozim-vendim për financimin e projektit “Klubi i Boksit Drenasi”
14. Propozim-vendim për financimin e projektit “Kv Gryka”
15. Plani lokal i veprimit zbutës për mbrojtje nga dhuna në familje dhe nga dhuna ndaj grave dhe vajzave Drenas 2025-2028;
16. Raporti financiar janar- mars 2025;
17. Të ndryshme.

Duke qenë se mbledhja e Kuvendit Komunal u ndërpre për shkak të mungesës së kuorumit, ju njoftoj se mbledhja do të vazhdojë sot prap me dt. 29.04.2025, në ora 14:30, në Kuvendin Komunal Drenas, me pikat të cilat kanë mbetur për diskutim.

Ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit të marrin pjesë, me qëllim që të përmbushim detyrimet tona dhe të shqyrtojmë çështjet e mbetura në rendin e ditës.

Mungese kuorumit perfundoj mbledhja.

Maj, 2025

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 19.05.2025, janë shqyrtuar gjashtë (6), pika të rendit të ditës.

1. Procesverbalin e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më datën 18.04.2025
2. Propozim-vendim për financimin e projektit "HANDIKOS"
3. Propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.
4. Propozim vendim për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024 dhe bartjen në vitin 2025.
5. Propozim vendim për bartjen e fondeve-të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025.
6. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 29.05.2025, ku janë shqyrtuar (6) gjashtë pika të rendit të ditës dhe janë miratuar katër (4) vendime.

1. Procesverbalin e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i mbajtur më datën 29.04.2025
2. Propozim-vendim për financimin e projektit "HANDIKOS"
3. Rregullore për plotësimin ndryshimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.
4. Propozim vendim për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024 dhe bartjen në vitin 2025.
5. Propozim vendim për bartjen e fondeve-të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025.
6. Rregullore për plotësim ndryshimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve.
7. Propozim vendim për shfuqizimin e përsëritshëm të Vendimit paraparak 02 Nr.030/01-46219 për dhënien e pronave të paluajtshme të Drenasit/Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizikë/ juridik (për 99 vite) i miratuar me datë 19.09.2024
8. Propozim vendim për shfuqizimin e Vendimeve 02 nr.462/01-11634, vendimit 02 nr.462/01-11636 dhe vendimit 02nr.462/01-11637 të datës 28.03.2025 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 35 vite pronat e paluajtshme të Komunës me procedurë të negociimi.
9. Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e rregullores për taksa tarifa ngarkesa dhe gjoba.
10. Të ndryshme.

QERSHOR, 2025

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 19.06.2025, janë shqyrtuar kater (4), pika të rendit të ditës.

1. Procesverbalin e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më datën 19.05.2025.
2. Draft Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028.
3. Informim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë 2025.
4. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 30.06.2025 , ku janë shqyrtuar (5) pesë pika të rendit të ditës dhe janë miratuar dy (2) vendime.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal i mbajtur më datën 29.05.2025.
2. Vendim për plotësim ndryshim të vendimit nr. 02.020/04-19803 dt. 29.05.2025 të komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba.
3. Draft Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028.
4. Informim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë 2025.
5. Të ndryshme.

KORRIK, 2025

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 21.07.2025, janë shqyrtuar pese (5), pika të rendit të ditës.

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më datën
2. 19.06.2025.
3. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Drenasit për vitin 2024.
4. Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes Lokale Janar-Qershor 2025.
5. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 30.07.2025, ku janë shqyrtuar (5) pesë pika të rendit të ditës.

1. Procesverbalin e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i mbajtur më datën 30.06.2025;
2. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Auditimit dhe pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Drenasit për vitin 2024;
3. Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes Lokale Janar-Qershor 2025;
4. Raporti Financiar Janar-Qershor 2025;
5. Të ndryshme.

GUSHT, 2025 Nuk pati mbledhje për arsyeje të pushimeve

SHTATOR, 2025

Mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa është mbajtur me datën 16.09.2025, janë shqyrtuar pese (3), pika të rendit të ditës.

1. Procesverbalin e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më datën 21.07.2025.
2. Draft Buxheti i Komunës për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027-2028.
3. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 25.09.2025, ku janë shqyrtuar (4) kater pika të rendit të ditës.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i mbajtur më datën 30.07.2025;
2. Draft Buxheti i Komunës për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027-2028;
3. Raporti i progresit për Implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2024.
4. Të ndryshme.

TETOR, NENTOR 2025

NUK PATI MBLEDHJE PËR ARSYE SE ISHTE FUSHATA ZGJEDHORE 2025

DHJETOR, 2025

Mbledhja Inaguruese 10/12/2025

- **10:00-10:15**, Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësve tjerë;
- **Hapja me Himnin e Flamurit**
- **Një minutë Heshtje për Dëshmorët e Rënë për Liri**
- **10:15- 10:30** Fjala mirëseardhëse e Anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës;
- **10:30- 10:45-** Kryesuesi i mbledhjes Fton anëtarët e kuvendit
 - Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës;
 - Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës;
- **10:45-11:00,** - Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës z. Ramiz Lladrovci.
- **11:00-11:15 - Mbyllja e seancës.**

Mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës 17.12.2025

1. Zgjedhja e Kryesuesit/ës të Kuvendit të Komunës.
2. Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
3. Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete.
4. Propozim vendim për themelimin e Këshillit për siguri në Bashkësi.

Pika 3 dhe 4 shtyhen për një seance tjetër për shkak që nuk kishin te propozuar për kandidat për shoqërinë civile dhe një përfaqësues nga bizneset.

Mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës 24.12.2025

1. Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete.
 2. Propozim vendim për themelimin e Këshillit Komunal për siguri në Bashkësi.
 3. Plani i punës të Kuvendit Komunal për vitin 2026.
 4. Plani i Punës së Kryetarit dhe drejtorive komunale për vitin 2026.
 5. Plani Lokal i veprimit në mjedis 2025-2029.
 6. Hartimi i planit Lokal për strategji të cilësisë së ajrit – Komuna e Drenasit 2025-2029.
 7. Plani komunal për integritet i Komunës së Drenasit i përditësuar për vitin 2026.
 8. Plani i Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera për Komunën e Glllogocit 2026–2029
 9. Plani i Reagimit Emergjent (PRE) për Komunën e Glllogocit.
 10. Raport për zbatimin e planit të integritetit për Komunën e Drenasit për gjashtë mujin e parë të vitit 2025.
 11. Raport për zbatimin e planit të integritetit për Komunën e Drenasit për gjashtë mujin e dytë të vitit 2025.
 12. Lista e rreziqeve komunale për vitin 2026.
 13. Raporti i vlerësimit të menaxhimit të rreziqeve të Komunës së Drenasit për vitin 2025.
 14. Raporti Financiar Janar-Shtator 2025.
 15. Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nga kryesuesi i KKSB-së për periudhën Janar-Dhjetor 2025
 16. Diskutimi i Raportit të Përformancës Komunale për vitin 2024.
- **Gjatë periudhës Janar - Dhjetor janë miratuar nga Kuvendi Komunal Drenas, gjithsej: 43 vendime prej tyre 4 nuk janë në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi tri (3) janë shfuqizuar ndërsa një është rishqyrtuar, ndërsa në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi mbeten 39 vendime .**

Të gjitha aktet komunale janë të përkthyer në gjuhën serbe dhe të bashkangjitura në dosje fizike dhe në intranet si dhe janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të Komunës.

- **Sa rregullore ka miratuar kuvendi i komunës për periudhën Janar – Dhjetor 2023 (Te bashkëngjitet lista me emrat e rregulloreve) ?**

Gjatë periudhës raportuese nuk ka pas rregullore vetëm plotësim rregullore.

Udhëheqëse e Sektorit të Kuvendit Komunal

Liridona Fejza-Ajazi